

Shërbimi i Seancës
Planare



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike

Nr. 1271 Prot.

Tiranë, më 26.03.2026

Lënda: Kërkesë për interpelancë urgjente me Ministrin e Brendshëm Besfort Lamallari

Baza Ligjore: Neni 80, pika 1 e Kushtetutës dhe neni 97 i Rregullores së Kuvendit

Drejtuar: Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë

Raporti i Zgjerimit i Komisionit European për Shqipërinë për vitin 2025 thekson se: *“Pavarësisht përpjekjeve të ndërmarra, Policia e Shtetit vazhdon të jetë thellësisht e ekspozuar ndaj korrupsionit. Procesi i vlerësimit kalimtar dhe periodik të punonjësve të policisë (“vetingu policor”), si dhe procesi i verifikimit të integritetit kanë vijuar, por ndikimi i tyre mbetet i kufizuar. Gjithashtu janë bërë më të dukshme rastet e intimidimit dhe kërcënimeve ndaj gazetarëve, përfshirë raste ku janë përfshirë edhe zyrtarë të lartë shtetërorë apo punonjës policie, veçanërisht ndaj gazetarëve investigativë dhe grave gazetare”¹.*

Ky konstatim i Komisionit European është veçanërisht shqetësues, pasi evidenton se edhe pas ndryshimeve ligjore dhe proceseve të verifikimit të integritetit, strukturat e Policisë së Shtetit vijnë të mbeten të cenueshme nga korrupsioni dhe ndikimi i aktorëve kriminalë.

Në të njëjtën linjë, edhe **Raporti i Komisionit European për Shqipërinë për vitin 2024** evidentonte se *“Policia e Shtetit mbetet shumë e ndjeshme ndaj korrupsionit dhe llogaridhënia mbetet e dobët, pavarësisht disa përpjekjeve kundër korrupsionit. Një proces verifikimi i integritetit brenda policisë, duke përfshirë deklarin e detyrueshëm mbi përdorimin nga stafi i policisë të mjeteve specifike të*

¹ https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/fe9138b7-90fe-4277-a12c3a03f6d1957f_en?filename=albania-report-2025.pdf

koduara për të komunikuar me grupet e krimit të organizuar, u prezantua që nga dhjetori 2023, pas zbulimeve që treguan një nivel të lartë të infiltrimit kriminal dhe korrupsionit në radhët e policisë”².

Shqetësimet për depërtimin e krimit të organizuar në strukturat e sigurisë në Shqipëri janë evidentuar edhe nga partnerët strategjikë të vendit. **Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit për Narkotikët** thekson se *grupet e krimit të organizuar të drejtuara nga shqiptarë luajnë një rol të rëndësishëm në furnizimin e tregjeve ndërkombëtare me kanabis, kokainë dhe heroinë, sipas autoriteteve shqiptare të zbatimit të ligjit. Këto grupe të krimit të organizuar shfaqin nivele gjithnjë e më të larta sofistikimi në krime, komunikime dhe teknika të pastrimit të parave. Krimi i dhunshëm në Shqipëri, përfshirë vrasjet me atentat, shpesh lidhet me krimin e organizuar, dhe gjyqtarë, prokurorë, policë, politikanë, gazetarë dhe aktivistë kanë qenë objekt intimidimi. Shqipëria merr pjesë në Koalicionin Global për Adresimin e Kërcënimeve nga Drogat Sintetike, por gjatë kësaj periudhe raportimi autoritetet nuk raportuan sekuestre të fentanilit apo drogave të tjera sintetike në sasi domethënëse. Korrupsioni, sundimi i dobët i ligjit dhe papunësia ushqejnë problemin e trafikut të drogës në Shqipëri.*³

Në të njëjtën linjë shqetësimi, edhe **Indeksi Global i Krimit të Organizuar për Shqipërinë** thekson se *rrjetet kriminale shqiptare janë ndër më me ndikim në rajon dhe operojnë si brenda vendit ashtu edhe në nivel ndërkombëtar. Këto rrjete janë të përfshira në një gamë të gjerë aktiviteteve të paligjshme, përfshirë trafikun e drogës, kontrabandën e armëve, vrasjet me pagesë dhe trafikun e qenieve njerëzore.*

“Korrupsioni brenda institucioneve politike dhe të zbatimit të ligjit në Shqipëri vazhdon të lehtësojë krimin e organizuar. Hetimet që përdorin platforma komunikimi të koduara kanë zbuluar lidhje të thella midis zyrtarëve të lartë dhe aktorëve kriminalë. Disa oficerë policie dhe gjyqësorë janë implikuar në ndihmën e rrjeteve kriminale, me disa të përfshirë drejtpërdrejt në aktivitete të paligjshme. Përfshirja e aktorëve të integruar në shtet shtrihet në tenderët publikë dhe kontratat qeveritare, ku grupet kriminale përdorin ryshfet dhe shantazh për të siguruar marrëveshje fitimprurëse. Përpjekjet e Prokurorisë Speciale Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK) kanë çuar në arrestimin e disa zyrtarëve të lartë qeveritarë; megjithatë,

² https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/a8eec3f9-b2ec-4cb187489058854dbc68_en?filename=Albania%20Report%202024.pdf

³ <https://www.state.gov/wp-content/uploads/2025/03/2025-International-Narcotics-Control-Strategy-Volume-1-Accessible.pdf>

korupsioni i rrënjosur brenda agjencive të tjera prokuroriale dhe të zbatimit të ligjit vazhdon të pengojë hetimet. Janë ngritur shqetësime në lidhje me nivelin e bashkëpunimit të policisë me krimin e organizuar, duke theksuar rastet ku rrjedhjet e brendshme kanë dëmtuar operacionet. Disa oficerë të lartë brenda njësive të specializuara janë implikuar në lehtësimin ose edhe drejtimin e grupeve kriminale.”⁴

Në këtë kontekst, Policia e Shtetit ka vuajtur prej kohësh nga një imazh negativ në opinionin publik, i cili është përkeqësuar ndjeshëm gjatë dy viteve të fundit. Arrestimet e disa oficerëve të lartë të policisë për përfshirje në rrjete kriminale, të zbuluara përmes komunikimeve të dekriptuara të aplikacionit **Sky ECC**, kanë tronditur rëndë besimin e publikut tek institucionet e sigurisë. Ish-drejtues të policisë, si **Oltion Bistri** dhe **Henerigert Mitri**, janë akuzuar për rrjedhje informacioni dhe për lehtësim të veprimtarive kriminale, përfshirë kultivimin masiv të kanabisit dhe plane për eliminimin e rivalëve kriminalë.⁵

Investigime të mediave dhe organizatave të shoqërisë civile kanë ngritur gjithashtu shqetësime serioze mbi depërtimin e krimit të organizuar në strukturat e policisë. Një investigim i publikuar nga rrjeti mediatik ballkanik **BIRN**, me titull *“Hijet e krimit të organizuar në Policinë e Shtetit”*, evidenton raste konkrete që sugjerojnë ekzistencën e një problemi sistemik.⁶

Në një nga rastet më tronditëse, më 11 nëntor, **Gilmando Dani**, një person i dënua për krim të organizuar, u vra në një atentat mafioz pranë aeroportit të Rinasit. Në këtë atentat u plagos edhe **Mustafa Sheqeri**, punonjës i Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore (AMP), i cili ndodhej në shoqërinë e viktimës. **Prania e një punonjësi të strukturës që mbikëqyr vetë policinë në një ngjarje të tillë kriminale ngriti pikëpyetje serioze mbi proceset e verifikimit të integritetit dhe procedurat e rekrutimit në institucionet e sigurisë.**

Hetimet e mëvonshme çuan në arrestimin e dy oficerëve të Policisë së Shtetit nga Komisariati Nr. 3 në Tiranë, të cilët dyshohen se kishin falsifikuar dokumentet e verifikimit të figurës së Sheqerit për të mundësuar punësimin e tij në AMP.

⁴https://ocindex.net/assets/downloads/2025/english/ocindex_profile_albania_2025.pdf

⁵ <https://publik.al/policia-e-shtetit-mes-reformave-dhe-dyshimeve-dhe-beteja-kunder-inkriminimit/>

⁶ <https://www.reporter.al/2025/11/14/kembane-alarmi-hijet-e-krimit-te-organizuar-ne-policine-e-shtetit/>

Sipas ekspertëve të sigurisë, bashkëpunimi mes punonjësve të policisë dhe grupeve kriminale mund të marrë forma të ndryshme, duke përfshirë **dekonspirimin e operacioneve policore, dhënien e informacionit për objektiva të grupeve kriminale apo paralajmërimin për kontrollet e forcave të rendit.**

Të dhënat zyrtare konfirmojnë gjithashtu përmasat e këtij problemi. Sipas raportimeve të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK), **rreth 70 oficerë policie ishin nën hetim për lidhje me krimin e organizuar deri në fund të vitit 2023**, ndërsa të dhënat e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore tregojnë një rritje të numrit të punonjësve të policisë të arrestuar për shkelje të ndryshme, nga **102 raste në vitin 2023 në 163 raste në fund të vitit 2024.**

Ekspertët e sigurisë ⁷⁸vlerësojnë se rrënjët e këtij problemi lidhen edhe me mënyrën e rekrutimit dhe promovimit në Policinë e Shtetit. Faktorë të tillë si **verifikimet e pamjaftueshme të figurës së kandidatëve, ndikimi i individëve me influencë në emërime, si dhe rënia e standardeve të përzgjedhjes** kanë krijuar një terren të përshtatshëm për depërtimin e elementëve të papërshtatshëm në strukturat e sigurisë. Infiltrimi i krimit të organizuar në strukturat e sigurisë përbën rrezik të drejtpërdrejtë për sigurinë kombëtare dhe për besueshmërinë e shtetit shqiptar ndaj partnerëve ndërkombëtarë.

Një problem tjetër i evidentuar është edhe ajo që ekspertët e quajnë **“kultura e heshtjes”**⁹ brenda institucioneve të sigurisë, ku punonjës të policisë që janë në dijeni të shkeljeve apo lidhjeve të kolegëve të tyre me krimin zgjedhin të mos i raportojnë ato për shkak të frikës së hakmarrjes apo mungesës së besimit në mekanizmat e raportimit.

Në këto kushte, duke pasur parasysh se:

- Raportet e institucioneve ndërkombëtare evidentojnë cenueshmërinë e Policisë së Shtetit ndaj korrupsionit dhe infiltrimit kriminal;
- Hetime dhe raportime publike kanë dokumentuar raste të përfshirjes së punonjësve të policisë në bashkëpunim me grupe kriminale;

⁷ <https://www.mcntv.al/lajme/kryesore/c6e19ca7-829c-480f-84c4-735c56150603>

⁸ <https://www.syrinet.net/politike/779810/policet-ne-sherbim-te-krimit-ish-drejtuesi-i-policise-inkriminimi-i-strukture-vjen-edhe-si-rezultat-i-frymes-ge-percjell-politika/>

⁹ <https://www.reporter.al/2025/11/14/kembane-alarmi-hijet-e-krimit-te-organizuar-ne-policine-e-shtetit/>

- Ekzistojnë dyshime serioze mbi procedurat e emërimit, promovimit dhe verifikimit të integritetit në strukturat drejtuese të Policisë së Shtetit;
- Këto zhvillime kanë cenuar rëndë besimin e publikut tek Policia e Shtetit dhe aftësinë e saj për të luftuar krimin e organizuar;

lindin disa pyetje që kërkojnë shpjegime nga ana e Ministrit të Punëve të Brendshme:

- Sa punonjës të Policisë së Shtetit janë aktualisht nën hetim, janë proceduar penalisht, janë arrestuar apo janë shkarkuar gjatë viteve 2023–2026 për lidhje me krimin e organizuar, korrupsion apo shpërdorim detyre?
- Cilat kanë qenë kriteret konkrete të emërimeve dhe promovimeve në pozicionet drejtuese të Policisë së Shtetit gjatë viteve të fundit?
- A ka kryer Ministria e Punëve të Brendshme një auditim të plotë të procedurave të emërimit dhe promovimit të drejtuesve të Policisë së Shtetit dhe cilat janë gjetjet e këtij auditimi?
- Cilat masa konkrete janë marrë për të parandaluar infiltrimin e krimit të organizuar në radhët e Policisë së Shtetit dhe për të garantuar integritetin e strukturave të saj?
- Sa punonjës të policisë kanë rezultuar përdorues të aplikacioneve Sky ECC apo EncroChat pas deklarimit të detyrueshëm të dhjetorit 2023 dhe sa prej tyre janë ende në detyrë?
- Sa nga arrestimet e kryera në radhët e Policisë së Shtetit kanë ardhur si rezultat i vetë-pastrimit të Policisë dhe sa si rezultat i dekriptimeve të Sky ECC/EncroChat nga partnerët ndërkombëtarë?
- Sa raste të dekonspirimit të operacioneve policore janë evidentuar gjatë viteve të fundit dhe cilat masa janë marrë ndaj punonjësve përgjegjës?
- Cila është përgjegjësia hierarkike e drejtuesve të AMP-së për punësimin e individëve me rekorde kriminale dhe a ka pasur shkarkime në nivele drejtuese për këtë rast?
- Cilat rezultate konkrete ka prodhuar procesi i verifikimit të integritetit të punonjësve të policisë dhe sa prej tyre janë larguar nga detyra si rezultat i këtij procesi?






Me qëllim dhënien e informacioneve dhe shpjegimeve lidhur me sa më lart, në cilësinë e deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë, në mbështetje të nenit 80, pika 1 të Kushtetutës dhe nenit 97 të Rregullores së Kuvendit,

K Ë R K O J M Ë:

- Zhvillimin e një interpelance urgjente me Ministrin e Punëve të Brendshme, z. Besfort Lamallari, lidhur me inkriminimin e Policisë së Shtetit dhe strukturave të tjera të sigurisë, procedurat e emërimit dhe promovimit në radhët e saj, si dhe masat për garantimin e integritetit dhe profesionalizmit të forcave të rendit.

Për sa më lart, në përputhje me nenin 97 të Rregullores së Kuvendit kërkojmë nga Kryetari i Kuvendit që kërkesën për interpelancë urgjente t'ia njoftojë Ministrit të Punëve të Brendshme dhe ta përfshijë atë si pikë të parë të Rendit të Ditës në seancën më të parë plenare të javës në vijim. Interpelanca do të realizohet nga deputeti Klevis Balliu.

DEPUTETËT:

1. KLEVIS BALLIU 
2. Sgti Cara 
3. GAZMENT BARDHI 
4. LUÇIANO BOSI 
5. Xhëlar Mzei 
6. Jon Gjermani 
7. BELIND KELLIQI 